



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 950/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharem Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arben Hoxha anëtarë i KKZ-së nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër Shaban Ajvazit Sekretar i Shkollës „Ismajl Qemajli” dhe ndihmës i menaxherit, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e parregullt ankesa e Arben Hoxha anëtarë i KKZ-së nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Kamenicë.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 20.11.2013 ka pranuar një ankesë nga anëtari i komisionit nga rradhët e subjekti politik PDK, në vendvotimin nr.100 ID/04R bëj anekesë për arsye se: Pasë përfundimit të gjithë procesit zgjedhor të votimit më 03.10.2013, sekretari i shkollës së mesme Shaban Ajvazi, njëherit zavendës menaxher në këtë vendvotim më ka kërkuar dhe këshilluar që ID- kartela ime të dorzohet ati për shkakë se këto kartela janë më të sigurta nëse qendrojn në atë qendër votuese me materialin tjetër josenzitiv, unë veprova ashtu . Pasi që kuptova nga anëtarët tjerë të komisionit se ID-kartelat i mbajn me vete, disa ditë më vonë shkova të sekretari të kerkojë kartelen time të leshuarë nga KQZ, dhe mora pergjigjëjen nga ai se ID-kartela ime nuk gjindet aty dhe është humbur. Prandaj parashtresesi i ankesës kërkon që të merret parasysht rasti.

PZAP-i pasi që shqyrtoi rregullsinë e ankesës gjeti se:

**Ankesa është e parregullt**

Nga shkresat e lëndës PZAP-i, konstatoi se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e parapara në bazë të nenit 3.6 pika d) të rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ku thuhet se të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese, vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj për këtë arsye duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 950/2013 më datën 21.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.